


Feedback i pjesëmarrësve në Digital Soft Skills dhe Digital Start-Up



Përgatitur nga: Besmire Aliu
Vendi: Prishtinë

OJQ In Time
Data: 25.04.2023 - 26.04.2023



Përmbajtja

Hyrje	2
Përshkrimi i Workshopeve	2
Metodologjia	3
Analiza e Feedback-ut të pjesëmarrësve	3
Digital Soft Skills.....	3
Digital Start-Up.....	8
Përmbledhje dhe Rekomandime	16
Përshkrimi i Planit të Veprimit.....	17
Përshkrimi i Autorëve të raportit dhe informacionet shtesë lidhur me organizatën.....	18



Hyrje

Raporti synon të analizojë efektivitetin e workshopeve "Digital Soft Skills" dhe "Digital Start-Up" në zhvillimin e aftësive digjitale të pjesëmarrësve. Tema e workshopit është përmirësimi i aftësive digjitale dhe zhvillimi i aftësive për nisjen e një biznesi digjital. Synimet e hulumtimit janë të identifikojnë përfitimet dhe sfidat e këtyre workshopeve duke analizuar feedback-un dhe perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me përmbajtjen, strukturën, dhe efektivitetin e tyre për të ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të tyre në të ardhmen.

Përshkrimi i Workshopeve

Workshopi "Digital Soft Skills" ka qenë i përqendruar në zhvillimin e aftësive të nevojshme për të përballuar sfidat në mjedisin digjital. Ka përfshirë tema si komunikimi online, menaxhimi i kohës në botën digjitale dhe njohuritë e nevojshme për të punuar me aplikacione dhe platforma të ndryshme digjitale. Struktura e programit ka përfshirë ligjërimet, punëtoritë praktike dhe detyra të përbashkëta për të aplikuar njohuritë në situata reale. Metodatat mësimore kanë përdorur prezantime multimediale, detyra praktike, diskutime dhe simulime për të promovuar një mësim efektiv dhe të përqendruar. Trajneri ka qenë një ekspert në fushën e teknologjisë dhe zhvillimit personal, i cili ka ofruar udhëzime të qarta dhe të përshtatshme për të ndihmuar pjesëmarrësit në zhvillimin e aftësive të tyre digjitale dhe të menaxhimit.

Workshopi "Digital Start-Up" ka synuar të përgatisë pjesëmarrësit për të nisur një biznes në ambientin digjital. Temat kanë përfshirë zhvillimin e ideve të biznesit, strategjitë e marketingut online, financat digjitale dhe menaxhimin e rrjeteve sociale për rritjen e biznesit. Struktura e programit ka përfshirë sesione trajnuese, konsultime individuale dhe punë në grup për të zhvilluar plane biznesi të realizueshme. Metodatat mësimore kanë përfshirë studime rastesh, analiza të industrive dhe detyra praktike për të promovuar një përvojë të pasur mësimore. Trajneri ka qenë një sipërmarrës i suksesshëm në fushën e teknologjisë dhe biznesit digjital, i cili ka ofruar udhëzime të specializuara dhe praktike për të ndihmuar pjesëmarrësit në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të tyre të biznesit.



Metodologjia

Metodologjia e hulumtimit për marrjen e Feedback-it nga pjesëmarrësit në workshopet "Digital Soft Skills" dhe "Digital Start-Up" ka përfshirë anketimin me pyetësor para fillimit të workshopit dhe pas përfundimit të workshopit. Ky proces ka filluar me hartimin e pyetësorëve të strukturuar të cilët janë dizajnuar për të marrë vlerësimet, perceptimet dhe komentet e pjesëmarrësve lidhur me përmbajtjen dhe efektivitetin e workshopeve. Pyetësorët janë përshtatur për të adresuar çështje specifike për secilën prej workshopeve, duke përfshirë pyetje të hapura dhe të mbyllura për të siguruar një gamë të gjerë të informacioneve. Pas hartimit të pyetësorëve, ata janë shpërndarë në mënyrë fizike në sesionet e workshopeve. Janë kryer 11 pyetësor në workshopin Digital Soft Skills dhe 12 pyetësor në workshopin Digital Start Up. Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e rezultateve është kryer për të identifikuar tendencat, përvojat dhe vlerësimet kryesore të pjesëmarrësve. Kjo metodologji ka përdorur një qasje të strukturuar dhe sistematike për të siguruar që të dhënat e marrura janë valide dhe për të nxjerrë përfundime të qëndrueshme dhe të besueshme në lidhje me efektivitetin e workshopeve.

Analiza e Feedback-ut të pjesëmarrësve

Analizë e rezultateve të feedback-ut, përfshinë aspektet pozitive dhe sfidat e identifikuara nga pjesëmarrësit, përqendrimin e tyre në përmbajtjen e workshopit, cilësinë e prezantimit, dhe ndonjë sugjerim për përmirësime të ardhshme. Në vazhdim do e paraqesim analizën e rezultateve në detaje.

Digital Soft Skills

Në pyetjen se sa keni njohuri për CV, 45.5% e pjesëmarrësve janë përgjigjur se kanë pak njohuri, 45.5% mesatarisht, dhe vetëm 9.1% posedojnë njohuri të mjaftueshme. Nga ky rezultat nënkuptojmë që është shumë e nevojshme marrja e njohurive në ndërtim të CV.




Figura 1. Niveli njohurie për CV



Tek pyetja për nivelin e njohurive për letrën motivuese, 54.5% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se kanë njohuri mesatare, 27.3% kanë pak njohuri, dhe 18.2% kanë një nivel më të lartë të njohurive rreth letrës motivuese. Ashtu si tek niveli i njohurive për CV, edhe tek letra motivuese është shumë e nevojshme të punohet ende në këtë drejtim për të ngritur nivelin e njohurive.




Figura 2. Niveli njohurie për Letër Motivuese

Terme të panjohura, ose pak të njohura ishin termet Digital Soft Skills dhe Digital Hard Skills, ku 54.5% kishin pak njohuri, dhe 45.5% kishin njohuri mesatare. Si fushë shumë e rëndësishme, dhe duke u bazuar në rezultate, duhet ngritur njohuritë në këtë drejtim.




Figura 3. Niveli njohurie për termin Digital Soft Skills

Ndërtimi profilit në rrjete sociale çdo ditë e më shumë po bëhet i domosdoshëm për të siguruar një prezencë online profesionale. 45.5% e pjesëmarrësve deklaruan se kanë pak njohuri deri mesatarisht, ndërsa 9.1% e tyre janë deklaruar se kanë shumë njohuri. Edhe në këtë fushë është e nevojshme të punohet seriozisht në mënyrë që të kemi nivel më të lartë të njohurive dhe profesionalizmit.




Figura 4. Niveli njohurie për ndërtimin e profilit në rrjete sociale dhe platforma të punësimit



Edhe pse janë zhvilluar numër i madh i workshopeve për soft skills, në këtë grup pjesëmarrësish vetëm 18.2% deklaruan se kanë ndjekë një herë një workshop të tillë, ndërsa 81.8% deklaruan se asnjëherë nuk kanë ndjekë workshope të tilla asnjëherë. Sipas këtyre të dhënave, është shumë e nevojshme të vazhdohet me realizim të workshopeve në soft skills apo digjital soft skills.




Figura 5. Ndjekja workshopeve në Digital Soft Skills

Në kuadër të workshkpit, ishte me rëndësi të merren informata nëse pjesëmarrësit kanë pasur rastin të përgatisin ndonjëherë CV dhe Letër motivuese. Prej tyre 36.4% nuk kishin përgatitur asnjëherë CV, si dhe 45.5% nuk kishin përgatitur asnjëherë letër motivuese. 27.3% kishin përgatitur vetëm njëherë CV, dhe 36.4% kishin përgatitur vetëm njëherë letër motivuese. Të dy rastet paraqesin përqindje të lartë të mungesës së njohurive praktike në këtë fushë paralelë me njohuritë teorike.



Figura 6. Përgatitja e CV dhe LM

Nëse pjesëmarrësit do të pyeteshin apo do tu kërkohej të përgatisin CV dhe Letër Motivuese me njohuritë momentale të cilat i posedojnë, prapë kemi përqindje të lartë të mos gatishmërisë së tyre, ku 63.6% deklaruan nivel mesatar të njohurive për të përgatitur CV, si dhe 54.5% letër motivuese.




Figura 7. Niveli njohurie për përgatitje të CV dhe LM



Pas përfundimit të workshopit, pjesëmarrësit u pyetën për përfitimet e tyre nga ky workshop.

Tek pyetja se sa keni përfituar njohuri për CV nga ky workshop, të gjithë pjesëmarrësit u përgjigjën se kanë përfituar shumë njohuri në një përqindje absolute 100%. I njëjti nivel i përqindjes ishte edhe për përfitim të njohurive për letër motivuese, pra 100%.




Figura 8. Përfitimi njohurive për CV dhe LM

Edhe pse në fillim të workshopit niveli njohurive për të përgatitur CV ishte shumë i ulët, pas përfundimit të workshopit ky nivel i njohurive u ngritë në 66.7% nivel mesatar të njohurive, dhe 33.3% nivel i lartë i njohurive. Përqindje e lartë e marrjes së njohurive ishte edhe për letër motivuese, ku 77.8% deklaruan se kanë arritur nivel të lartë të njohurive, dhe vetëm 22.2% nivel mesatar të njohurive.




Figura 9. Niveli njohurie për përgatitje të CV dhe LM pas Workshopit

U ngritë përqindja e marrjes së njohurive edhe për ndërtim të profilit profesional në rrjete sociale me 66.7% nivel të lartë të njohurive dhe 33.3% nivel mesatar të njohurive.




Figura 10. Niveli njohurie për përgatitje të profileve në rrjete sociale dhe platforma të punësimit pas workshopit



Ishte me rëndësi që pas përfundimit të workshopit të pyeten pjesëmarrësit nëse ende kanë nevojë për të marrë njohuri për Digital Soft Skills, dhe 55.6% deklaruan se ndoshta kanë ende nevojë, 33.3% deklaruan se kanë nevojë ende, dhe vetëm 11.1% deklaruan se më nuk kanë nevojë për workshope të tilla.




Figura 11. Nevoja për njohuri në Digital Soft Skills

Pavarësisht pyetjeve vlerësuese teknike mbi digjital soft skills, ishte shumë me rëndësi edhe vlerësimi workshopit në përgjithësi, dhe me një përqindje rreth 100% pjesëmarrësit deklaruan se workshopi ishte në një nivel shumë të lartë.



Figura 12. Vlerësimi workshopit në përgjithësi

Rekreativiteti dhe praktika janë dy elemente shumë të rëndësishme në një workshop. Në këtë workshop 55.6% e pjesëmarrësve vlerësuan se workshopi ka qenë shumë rekreativë dhe praktikë, ndërsa 44.4% menduan se workshopi ishte në nivel mesatar.




Figura 13. Rekreativiteti dhe praktika në workshop



Profesionalizmi trajnerit është shumë me rëndësi, dhe ne e kishim me rëndësi të marrim opinionin e pjesëmarrësve në këtë drejtim. 88.9% e pjesëmarrësve vlerësuan se trajneri ishte profesional në një nivel shumë të lartë, dhe 11.1% e pjesëmarrësve vlerësuan se trajneri ishte profesional në nivel mesatar.




Figura 14. Profesionalizmi trajnerit/trajneres

A ka diçka që kishit veçuar nga workshopi? Në këtë pyetje përgjigjejet ishin si vijon:

1. *Gjithçka shumë mirë, e kuptueshme dhe e qartë,*
2. *Këshilla dhe mësimet e reja për teknologji,*
3. *Gjithçka ishte e qartë dhe interesante,*
4. *Nuk kam ndjekur këso workshope dhe ishte workshop rekreativë,*
5. *Motivues, shumë interesant,*
6. *Videot e ndryshme të prezantuara nga trajnerja ishin shumë të mira dhe kreative, etj.*

Digital Start-Up

Kemi një përqindje të lartë të mungesës së njohurive sa i përket ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për realizim profesional të një ideje biznesi. 50% e pjesëmarrësve kanë thënë se kanë pak njohuri, 41.7% mesatarisht, dhe 8.3% shumë.




Figura 15. Njohuritë mbi hapat e parë të realizimit të idesë së biznesit



Gjithashtu edhe tek domosdoshmëria e njohurive për hulumtim të tregut, rezultoi me mungesë të njohurive me 50% prej tyre me njohuri mesatare, 16.7% pak njohuri, dhe 33.3% shumë njohuri.




Figura 16. Njohuritë mbi hulumtimin e tregut para hapjes së biznesit

Përqindje brengosëse ishin tek pyetja mbi njohuritë e definimit të saktë të idesë së biznesit me 58.3% me njohuri mesatare dhe 41.7% me pak njohuri.




Figura 17. Njohuritë mbi hapat e definimit të saktë të idesë së biznesit

Promovimi i biznesit si para hapjes së tij ashtu edhe pas hapjes së tij luan një rol shumë të rëndësishëm. Njohuritë e pjesëmarrësve në këtë drejtim ishin 58.3% me njohuri mesatare, 25% me pak njohuri, dhe 16.7% shumë njohuri.




Figura 18. Njohuritë mbi hapat e promovimit të idesë së biznesit



Kishte njohuri mesatare me rreth 41.7% për rëndësinë e punësimit të stafit të kualifikuar në biznes, 25% kishte pak njohuri, dhe 33.3% kishte shumë njohuri.




Figura 19. Njohuritë mbi rolin dhe rëndësinë e punësimit të stafit të kualifikuar në biznes

Shitësi si njëri nga faktorët kyç për një biznes të suksesshëm, për fat të keq në vendin tonë nuk vlerësohet për një gjë të tillë. Përgjigjejet e pjesëmarrësve mbi rolin, rëndësinë, dhe profesionalizmin e shitësit ishin 58.3% me njohuri mesatare, 33.3% shumë njohuri, dhe 8.3% pak njohuri.




Figura 20. Njohuritë mbi rolin, rëndësinë dhe profesionalizmin e shitësit në biznes

Lidershipi thuhet një terminologji dhe praktikë e panjohur. 58.3% kishin njohuri mesatare për lidërsip, 33.3% kishin pak njohuri, dhe 8.3% prej tyre kishin shumë njohuri.




Figura 21. Njohuritë mbi lidërsipin në biznes



Kishte përqindje brengosëse në njohuritë e pjesëmarrësve mbi format e ndryshme të sigurimit të fondeve. Përgjigjejet ishin 50% pak njohuri, dhe 50% njohuri mesatare.




Figura 22. Njohuritë për sigurimin e fondeve për hapje të biznesit

Pjesëmarrësit nuk kishin ndjekur asnjëherë workshop për “Digital Start-Up”, dhe si rrjedhojë 100% prej tyre u deklaruan se nuk kanë ndjekur një workshop të tillë.




Figura 23. Ndjekja e workshopeve në të kaluarën në Digital Start-Up

Nga ky workshop, 83.3% e pjesëmarrësve deklaruan se përfituan shumë njohuri nga ky workshop, dhe 16.7% morën njohuri mesatare nga workshopi.




Figura 24. Përfitimi njohurive nga workshopi për Digital Start-Up



Përçindje e lartë e përfitimit të njohurive ishte edhe mbi hapat e parë të realizimit të idesë së biznesit me rreth 83.3% që morën shumë njohuri, 8.4% morën njohuri mesatare, dhe 8.3% morën pak njohuri.




Figura 25. Përfitimi njohurive mbi hapat e parë të realizimit të idesë së biznesit

Kishte rezultate pozitive mbi marrjen e njohurive për nevojën e domosdoshme të hulumtimit të tregut para hapjes së biznesit. 66.7% deklaruan se morën shumë njohuri, dhe 33.3% deklaruan se morën njohuri mesatare.




Figura 26. Përfitimi njohurive mbi nevojën e hulumtimit të tregut

Rreth 66.7% e pjesëmarrësve morën shumë njohuri mbi hapat e definimit të saktë të idesë së biznesit, dhe 33.3% morën njohuri mesatare.




Figura 27. Përfitimi njohurive mbi hapat e definimit të saktë të idesë së biznesit



Rezultoi përqindje e lartë e përfitimit mbi hapat e promovimit të biznesit para dhe pas hapjes së tij me rreth 75% përfitim të shumtë të njohurive, dhe 25% përfitim mesatar të njohurive.




Figura 28. Përfitimi njohurive mbi hapat e promovimit të idesë së biznesit

Pjesëmarrësit kishin përfituar shumë njohuri mbi rolin dhe rëndësinë e punësimit të stafit të kualifikuar në biznes me rreth 66.7%, dhe njohuri mesatare me rreth 33.3%.




Figura 29. Përfitimi njohurive mbi rolin dhe rëndësinë e punësimit të stafit të kualifikuar

Përfitimi njohurive mbi rolin dhe rëndësinë e profesionalizmit të shitësit në biznes ishte gjithashtu në një përqindje të lartë me rreth 75%, dhe njohuri mesatare 25%.




Figura 30. Përfitimi njohurive mbi rolin, rëndësinë dhe profesionalizmin e shitësit në biznes



Kishte përqindje të kënaqshme sa i përket përfitimit të njohurive mbi rolin dhe rëndësinë e leadershipit në biznes. 58.3% përfituan shumë njohuri, dhe 41.7% përfituan njohuri mesatarisht.




Figura 31. Përfitimi njohurive mbi rolin dhe rëndësinë e leadershipit në biznes

Pjesëmarrësit përfituan mjaftueshëm njohuri edhe mbi sigurimin e fondeve për hapje të biznesit. 50% prej tyre përfituan shumë njohuri, 41.7% përfituan mesatarisht njohuri, dhe 8.3% përfituan pak njohuri.




Figura 32. Përfitimi njohurive mbi sigurimin e fondeve të hapjes së biznesit

Rekreativiteti dhe praktika si elemente shumë të rëndësishme të workshopit, në këtë rast rezultuan me përgjigjeje 91.7% si workshop shumë rekreativë dhe praktikë, dhe 8.3% rezultuan me rekreativitet dhe praktikë mesatare.




Figura 33. Rekreativiteti dhe praktika në workshop



Trajnerja u vlerësua me një përqindje të lartë të nivelit të profesionalizmit me rreth 91.7% si nivel shumë i lartë, dhe 8.3% nivel mesatar.




Figura 34. Profesionalizmi trajnerit/trajneres në workshop

A ka diçka që kishit veçuar nga workshopi?

- *Pozitive në nxitjen e kureshtjes për hulumtim të mëtutjeshëm*
- *Shumë interesant; nuk kemi ndjekur asnjëherë këso workshope; rekreativë*
- *Nuk kemi ndjekur asnjëherë këso workshope; rekreativë;*
- *Interesant*
- *Nuk kam për të cekur diçka, vetëm duke ju falënderuar për mundësinë e dhënë për të qenë pjesë e workshopit*
- *Motivues; interesant*
- *Motivues por edhe real, iniciativë shumë e mirë*
- *Aktivitet shumë kreativë, i qasshëm dhe i krijuar në një ambient shumë miqësor*
- *Workshop shumë praktik*
- *Workshop motivues dhe praktikë*
- *Interesant, motivues dhe shumë ndihmës*



Përmbledhje dhe Rekomandime

Pas analizës së rezultateve të feedback-ut të pjesëmarrësve në workshopet "Digital Soft Skills" dhe "Digital Start-Up", mund të nxjerrim disa përfundime dhe rekomandime për të përmirësuar ofrimin e workshopeve në të ardhmen. Këto përfundime dhe rekomandime janë si vijon:

Përmirësimi i Nivelit të Njohurive: Në anketën fillestare, u zbulua se disa pjesëmarrës kanë pasur nivel të ulët të njohurive për temat e workshopeve, si ndërtimi i CV-së, letrës motivuese, dhe digital soft skills. Është e rëndësishme të përmirësohet përgatitja fillestare për të siguruar që pjesëmarrësit kanë njohuritë bazike para fillimit të workshopeve.

Përdorimi i Metodave të Ndryshme Mësimore: Pjesëmarrësit vlerësuan lartë rekreativitetin dhe praktikën në workshopet e tyre. Në të ardhmen, mund të konsiderohen më shumë aktivitete praktike dhe studime rastesh për të përforcuar përvojën mësimore dhe për të bërë workshopet më të përshtatshme për pjesëmarrësit.

Përmirësimi i Fokusit në Ndryshimet e Biznesit: Për workshopin "Digital Start-Up", një përqindje e lartë e pjesëmarrësve nuk kishin ndjekur asnjëherë një workshop të tillë. Kjo tregon nevojën për të promovuar dhe ofruar më shumë workshope për nisjen e një biznesi digjital. Workshopi duhet të përqendrohet më shumë në strategjitë e financave digjitale dhe zhvillimin e ideve të biznesit për të përgatitur pjesëmarrësit për sfidat dhe mundësitë e biznesit digjital.

Ngritja e Nivelit të Njohurive për Digital Soft Skills: Pjesëmarrësit identifikuan një mungesë të njohurive për termet si "Digital Soft Skills" dhe "Digital Hard Skills". Workshopi duhet të përfshijë një përjasje të qartë dhe të strukturuar për të zhvilluar këto aftësi të nevojshme në botën digjitale.

Përmirësimi i Bashkëveprimit në Grup: Në disa raste, pjesëmarrësit raportuan mungesë të njohurive praktike për ndërtimin e CV-së dhe letrës motivuese. Workshope mund të përfshijnë më shumë aktivitete në grup dhe diskutime për të inkurajuar bashkëpunimin dhe mësimin reciprok midis pjesëmarrësve.

Vendosja e Përqafimit të Digitalizmit: Në një botë që po bëhet gjithnjë e më e digitalizuar, është e rëndësishme që workshopet të fokusohen në aftësitë digjitale si ndërtimi i profileve në rrjete sociale, njohuria e aplikacioneve dhe platformave të ndryshme digjitale, dhe menaxhimi i informacionit në ambientin digjital.

Vazhdimi i Workshopeve: Pjesëmarrësit shprehën interes për workshope të tjera në të ardhmen. Është e rëndësishme që organizatorët të vazhdojnë të ofrojnë workshope të specializuara në temat që interesojnë pjesëmarrësit dhe të sigurojnë një përvojë të vlerësueshme mësimore.



Monitorimi dhe Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Workshopeve: Është e rëndësishme të monitorohen vazhdimisht efektiviteti dhe përshtatshmëria e workshopeve në përputhje me nevojat e pjesëmarrësve. Kjo mund të bëhet përmes vazhdimësisë së feedback-it dhe analizës së rezultateve për të identifikuar çdo nevojë për përmirësime në ofrimin e workshopeve.

Në përgjithësi, duke marrë parasysh feedback-in dhe rezultatet e analizës, është e rëndësishme të vazhdohet me përpjekjet për të ofruar workshope cilësore dhe të përshtatshme që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive digjitale dhe në nxitjen e nismave të biznesit në mjedisin digjital.

Përshkrimi i Planit të Veprimit

Bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga analiza e feedback-it dhe rezultatet e hulumtimit për workshopet "Digital Soft Skills" dhe "Digital Start-Up", është e rëndësishme të zhvillojmë një plan të veprimit që adreson çështjet identifikuar dhe që synon të përmirësojë workshopin në të ardhmen. Këtu është një përshkrim i planit të veprimit:

Rivlerësimi i Strukturës së Workshopeve: Do të rivlerësojmë strukturën e workshopeve për të siguruar që ato ofrojnë një përvojë të pasur mësimore dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit. Do të shqyrtojmë se si workshopet mund të përfshijnë më shumë aktivitete praktike, studime rastesh, dhe punë në grup për të promovuar mësimin reciprok dhe zhvillimin e aftësive të aplikueshme.

Përmirësimi i Përgatitjes fillestare: Do të ndryshojmë dhe përmirësojmë materialet dhe përgatitjen fillestare për të siguruar që pjesëmarrësit kanë njohuritë bazike për temat që do të trajtohen në workshope. Kjo përfshin përgatitjen për ndërtimin e CV-së, letrës motivuese, dhe njohuritë themelore digjitale.

Përdorimi i Metodave Mësimore të Përshtatshme: Do të përdorim një gamë të gjerë metodash mësimore për të adresuar nevojat e ndryshme të pjesëmarrësve. Kjo përfshin prezantime multimediale, detyra praktike, diskutime, dhe simulime për të krijuar një përvojë mësimore të angazhuese dhe efektive.

Specializimi në Digital Soft Skills dhe Digital Hard Skills: Do të zhvillojmë module të veçanta për të trajtuar aftësitë digjitale themelore dhe të avancuara, duke përfshirë menaxhimin e informacionit, komunikimin online, dhe njohuritë për të punuar me teknologji dhe aplikacione të ndryshme.



Promovimi i Workshopeve: Do të intensifikojmë përpjekjet për të promovuar workshopet në mesin e publikut të synuar, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi dhe partneritete me organizata të interesuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen.

Monitorimi dhe Vlerësimi i Efektivitetit: Do të vazhdojmë të monitorojmë dhe të vlerësojmë efektivitetin e workshopeve duke përdorur një gamë të ndryshme metodash. Kjo përfshin analizën e feedback-it, vlerësimet e pjesëmarrësve, dhe ndjekjen e rezultateve të përmirësimit të aftësive të pjesëmarrësve.

Rritja e Bashkëpunimit dhe Partneritetit: Do të kërkojmë bashkëpunim dhe partneritete me organizata, institucione, dhe ekspertë në fushën e digjitalizmit dhe sipërmarrjes për të siguruar që workshopet ofrojnë një përvojë të pasur dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit.

Rivlerësimi i Materialesh dhe Temave: Do të bëjmë një rivlerësim të materialesh dhe temave të workshopeve për të siguruar që ato reflektojnë nevojat e aktualizuara dhe zhvillimet në botën digjitale dhe sipërmarrjen.

Përmes këtij plani të veprimit, synojmë të sigurojmë që workshopet "Digital Soft Skills" dhe "Digital Start-Up" ofrojnë një përvojë të përmirësuar dhe të pasur për pjesëmarrësit duke adresuar çështjet e identifikuara dhe duke përmirësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre për nevojat e të ardhmes.

Përshkrimi i Autorëve të raportit dhe informacionet shtesë lidhur me organizatën

Autori i raportit ishte Besmire Aliu, mastër e shkencave ekonomike, njëkohësisht dhe drejtoreshë ekzekutive në OJQ "In Time" që nga viti 2020, si dhe me një përvojë shumëvjeçare në hulumtim dhe analiza.

OJQ "In Time" ofron një numër të madh workshopesh në fusha të ndryshme si në fushë të ICT, Start-Up, menaxhim biznesi, menaxhim prodhimi, soft skills, aftësi të ndryshme profesionale, etj.